

BULETIN JAVOR

14-18 GUSHT 2023



Shprehja

"Pasi të humbni privatësinë tuaj, kuptoni se keni humbur një gjë jashtëzakonisht të vlefshme."

Billy Graham

e javës

Përmbajtja:

- Takimi zyrtarë i Ambasadores së Izraelit me Autoritetin Kombëtarë për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
- LinkedIn shenjëstrohet nga aktorë kërcënues në një valë të gjatë sulmesh
- Discord.io konfirmon shkeljen e të dhënave për 760 mijë përdorues
- Goole Chrome - Patching Alert



Takimi zyrtarë i Ambasadores së Izraelit me Autoritetin Kombëtarë për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike

Në datën 15 Gusht, Ambasadorja e Izraelit, znj. Galit Peleg, në kuadër të miqësisë dhe bashkëpunimit midis vendeve tona, zhvilloi një takim zyrtarë pranë Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, ku u prit nga Drejtori i Përgjithshëm z. Igli Tafa dhe stafi i Autoritetit. Në këtë takim u diskutua mbi mundësi bashkëpunimi midis institucioneve të dy vendeve, përfshirë edhe institucionet në fushën e sigurisë Kibernetike.

Znj. Ambasadore, shprehu vlerësimin dhe konsideratën për një zhvillim të madh që ka marrë Shqipëria në një kohë të shkurtër në sektorë të ndryshëm, përfshirë edhe fushën e Sigurisë Kibernetike. Drejtori i Autoritetit Z. Tafa, i shprehu Ambasadores falenderimet për mbështetjen e dhënë si dhe parashitroi sfidat dhe strategjinë institucionale e drejtuar për të mundur një rritje të nivelit të Sigurisë Kibernetike në vend.




LinkedIn shenjëstrohet nga aktorë kërcënues në një valë të gjatë sulmesh

LinkedIn është duke u shenjestrue në një valë të gjatë sulmesh që rezultojnë në mbylljen e shumë llogarive për arsye sigurie.

Siç është raportuar nga Cyberint, shumë përdorues të LinkedIn janë ankuar për bllokimin e llogarisë dhe pamundësinë për të zgjidhur problemet përmes suportit të LinkedIn.

Sulmuesit duket se po përdorin kredencialet e zbuluara për të tentuar të marrin kontrollin e një numri të madh llogarish në LinkedIn.

[Lexo më shumë](#)



Discord.io konfirmon shkeljen e të dhënave për 760 mijë përdorues

Shërbimi Discord.io është mbyllur përkohësisht pasi pësoi një shkelje të të dhënave duke ekspozuar informacionin e 760,000 anëtarëve.

Informacioni i përhapur përfshin emrin e përdoruesit, adresa e emailit, adresa e faturimit, fjalëkalimi dhe ID-ja e Discord.

Discord.io ka konfirmuar vërtetësinë e vjedhjes së të dhënave në një njoftim për serverin dhe faqen e tij të internetit Discord dhe ka filluar të mbyllë përkohësisht shërbimet e tij.

[Lexo më shumë](#)

PATCHING ALERT

New in
Chrome

116

Google përditëson 26 vulnerabilitete.

Google ka lançuar versionin më të fundit të shfletuesit të tij Chrome, duke adresuar 26 vulnerabilitete, nga të cilat 8 klasifikohen si kritike.

Chrome 116 mbulon përditësimet për pjesë të ndryshme funksionaliteti, duke përfshirë, motorin V8, Device Trust Connectors, Fullscreen, Network, ANGLE dhe Skia.

Versioni më i fundit i Chrome shfaqet si versioni 116.0.5845.96 për Mac dhe Linux dhe si versioni 116.0.5845.96/97 për Windows.

AKCESK këshillon të gjithë përdoruesit e Google Chrome të kryejnë përditësimet e nevojshme.

[Lexo më shumë](#)